



---

**VENDIM**  
**Nr. 9 Date 29.01.2010**

**PËR**  
**AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “HIDROINVEST 1” SH.P.K PËR**  
**NDRYSHIMIN E AKSIONERIT QË KONTROLLON INTERESAT**  
**(ZOTËRON PAKETËN KONTROLLUESE)**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15 pika 1, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikes 6.2, të “Licenses për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.01.2010, mbasi shqyrtoi kërkesen e paraqitur nga shoqëria “HIDROINVEST 1” sh.p.k, për marrjen e autorizimit për ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Dhe Konstatoi se:**

1. Shoqëria “HIDROINVEST 1” sh.p.k është licensuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.113, dt.24.09.2008.
2. Propozimi për shitjen e aksioneve të “HIDROINVEST 1” sh.p.k shkakton ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat.
3. Ndryshimi i aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë i shërben shtimit të kapacitetit teknik të kompanisë dhe uljes në mënyrë të ndjeshme të nivelit të kreditimit nga bankat për realizimin e investimit, si dhe në përmbushjen e detyrimeve të Marreveshjes së Koncesionit dhe Licenses së Prodhimit të Energjisë Elektrike,

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të autorizojë shoqërinë “HIDROINVEST 1” sh.p.k, për ndryshimin e aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGIJE**  
Bordi i Komisionereve



---

**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**

***VENDIMIN***  
***Nr. 9 Date 29.01.2010***

**PËR**  
**AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “HIDROINVEST 1” SH.P.K PËR**  
**NDRYSHIMIN E AKSIONERIT QË KONTROLLON INTERESAT**  
**(ZOTËRON PAKETËN KONTROLLUESE)**

**Anëtarët e Bordit**

	Pro	Kundër
<b>Bujar Nepravishta</b>	_____	_____
<b>Entela Shehaj</b>	_____	_____
<b>Ardian Haçi</b>	_____	_____
<b>Abaz Aliko</b>	_____	_____
<b>Shkelqim Bozgo</b>	_____	_____

